

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm

Constitutional Paragraph: Neni 31.1

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 14 para 1.

Pakti Nderkombëtar
për të Drejtat civile
dhe Politike
Pakti Nderkombëtar
për të Drejtat civile
dhe Politike

1. Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanshësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. Shtypi dhe publiku mund të largohen gjatë gjithë procesit ose të një pjese të tij, qoftë kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, i rendit publik ose i sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, qoftë edhe kur gjykata e quan krejtësisht të domosdoshme në qoftë se, për disa rrethana të veçanta të çështjes, publiciteti mund të dëmtojë interesat e drejtësisë; megjithatë çdo gjykim i dhënë në çështjen penale ose civile do të jetë publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijëve.

Neni 6 para. 1

Konventa Evropiane
për Mbrojtjen e të
Drejtave dhe Lirive
Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane
për Mbrojtjen e të
Drejtave dhe Lirive
Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojë interesat e drejtësisë.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 10

Deklarata Universale

për të Drejtat e Njeriut

Deklarata Universale

për të Drejtat e Njeriut

Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij.

Ligjet

Nenet

Neni 3

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR

GJYKATAT

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR

GJYKATAT

Ushtrimi i Pushtetit Gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me këtë ligj.

2. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

Neni 4

Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatave

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR

GJYKATAT

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR

GJYKATAT

1. Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. ‘

2. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike

Ligjet

Nenet

Neni 7

Qasja në Gjykata

1. Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR
GJYKATAT
LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR
GJYKATAT

2. Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor. 3. Çdo person ka të drejtë t' i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij të ligjshme. Çdo person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër një vendimi gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtën apo interesat e tij në mënyrën e caktuar me ligj.

4. Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.

5. Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.

Ligjet

LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E
SPECIALIZUARA DHE
ZYRËN E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR
LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E
SPECIALIZUARA DHE
ZYRËN E PROKURORIT TË
SPECIALIZUAR

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

Nenet

Neni 21

4. Në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas këtij ligji, i akuzuari gëzon të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, me barazi të plotë që:
- të njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij,
 - të informohet me kohë për të drejtat e tij sipas ligjit,
 - të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe të komunikojë me Mbrojtësin e Specializuar të zgjedhur prej tij,
 - të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme, e. të gjykohet me praninë e tij, dhe të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t'i caktohet Mbrojtës i Specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar,
 - t'i merr në pyetje, ose t'i ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij,
 - të ketë ndihmën falas të përkthyesit, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në Dhomën e Specializuar dhe
 - të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo të pranojë fajësinë

Neni 5

Gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm

- Çdo person i dyshuar ose të akuzuar i garantohet gjykim i drejtë dhe i paanshëm.
- Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.
- Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.
- Kushdo që është privuar nga liria me arrest, menjëherë njoftohet në gjuhën që e kupton për arsyet e heqjes së lirisë. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës sillet para gjyqtarit të gjykatës themelore në juridiksionin e arrestimit brenda dyzet e tetë (48) orëve. Gjyqtari vendos për caktimin e paraburgimit, në pajtim me Kapitullin X të këtij Kodi

decisionTitle* **decisionDescription***

T and V v The
United Kingdom

T and V v The United Kingdom: ECHR 8 Apr 1999: Ky rast i referohet gykimit publik në një gjykatë lidhur me të mitur të akuzuar për vrasje dhe shqiptim të dënimit me burg prej pesëmbëdhjetë vjetësh. Gjykimi i dy të miturve në një forum publik, nën një kontroll të ashpër publik, e bëri gjyqin të padrejtë: 'është thelbësore që një fëmijë i akuzuar për një vepër penale të trajtohet në atë mënyrë që të marrë parasysh plotësisht moshën e tij, nivelin e pjekurisë dhe aftësitë intelektuale dhe emocionale, dhe ato hapa të ndërmarrë për të promovuar aftësinë e tij për të kuptuar dhe marrë pjesë në procedurë.' Një masë ndëshkuese duhet të vendoset nga gjykatat, dhe jo nga një proces politik, dhe një dënim i gjatë për një fëmijë duhet të lejojë zhvillime të mëvonshme: 'caktimi i një afati minimal ishte pjesë e procedurave dhe ishte një ushtrim dënimi; pra, neni 6 (1) ishte i zbatueshëm; që këtij neni i garantohet një seancë dëgjimore e drejtë nga një gjykatë e paanshme e pavarur nga ekzekutivi; dhe se Sekretari i Shtetit nuk ishte qartë i pavarur nga ekzekutivi.

Ferantellidhe
Santangelo
kundër Italisë

Në çështjen Ferantellidhe Santangelo kundër Italisë Gjykata u shpreh se gjashtëmbëdhjetë vjet ishin të paarsyeshëm në këtë çështje që kishte të bënte me një gjyq kompleks e të vështirë në lidhje me një vrasje ku përfshiheshin probleme të ndjeshme në trajtimin e të miturve.

Schuler-
Zraggen
kundër Zvicrës

Në çështjen e Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, që kishte të bënte me pensionet e invalidëve, Gjykata deklaroi në përgjithësi se "...zhvillimet në të drejtën...dhe garantimi i trajtimit të parimit të barazisë duke pasur parasysh faktin se sot rregulli i përgjithshëm është që Neni 6 (1) zbatohet faktikisht në fushën e sigurimeve shoqërore duke përfshirë madje edhe asistencën për mirëqënie".